



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 15.04.2026

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 020/01-5629/20
15.04.2026
Dragash - Dragaš

PROCESVERBAL

**Konsultim publik për Draftin e Strategjisë për Komunikim dhe
Marrëdhënie me Publikun 2026-2030
I mbajtur më 10.04.2026 (e premte)
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash**

Konsultimi publik elektronik dhe me shkrim për Draftin e Strategjisë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026-2030 ka zgjatur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga data 26.03.2026 deri më 10.04.2026. Publikimi i njoftimit për konsultim publik është bërë më datën 27.03.2026, në platformat zyrtare të Komunës.

Njoftimi në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/Njoftim-per-diskutim-publik.pdf>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/Obavestenje-za-javnu-raspravu.pdf>

Njoftimi në Facebook-un zyrtar:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/1B7JeJkvzw/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/18iKWRSSor/>

Drafti i publikuar në rubrikën për konsultime publike:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/Draftstrategjia-per-Komunikim-2026-2030.docx>

<https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/Plani-i-Veprimit.docx>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/Strategjia-za-Komunikaciju-2026-2030.docx>

<https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/Akcioni-plan.docx>

Diskutimi publik është mbajtur më **10.04.2026, e premte**, dhe ka filluar në **ora 11:00**.

Në këtë diskutim publik kanë qenë prezentë **21 pjesëmarrës, prej tyre 17 meshkuj dhe 4 femra**.

Hapjen e takimit dhe prezantimin e draftdokumentit e ka bërë zyrtari për Informim, Fari Kolloni, në cilësinë e anëtarit të Grupit Punues për hartimin e Strategjisë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026-2030.

Fari Kolloni: Përshëndetje për të gjithë dhe faleminderit që keni gjetur kohë të jeni të pranishëm në diskutimin e sotëm lidhur me Draftin e Strategjisë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026-2030, një dokument ky i rëndësishëm i politikave lokale të Komunës së Dragashit i cili, pas kalimit të procedurave të konsultimit publik dhe miratimit përfundimtar në Kuvendin e Komunës, do të na shërbejë në funksion të përmirësimit dhe rritjes së transparencës së institucionit tonë karshi qytetarëve. Po fillojmë në pika të shkurtëra me prezantimin e përmbajtjes së Draftit. Përgjithësisht, dokumenti është i ndarë në dy pjesë kryesore: është pjesa narrative e cila përmban nëntë kapituj dhe si shtojcë e kemi Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë, i cili përmban aktivitetet konkrete të cilat do të realizohen për arritjen e objektivave të Strategjisë.

1. HYRJA

Përshkruhet prezantimi i Strategjisë dhe angazhimi i Komunës së Dragashit për transparencë dhe komunikim të hapur. Theksohet rëndësia e informimit të drejtë, dialogut me qytetarët dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje. Në fund, evidentohet roli i komunikimit të brendshëm dhe ngritja e kapaciteteve për një administratë më efikase.

2. SFONDI

2.1. Profili i Komunës

Përshkruhet profili i Komunës së Dragashit, duke përfshirë pozitën gjeografike, territorin, relievin dhe klimën karakteristike. Theksohet gjithashtu rëndësia e zonave të mbrojtura dhe Parkut Nacional.

2.2. Administrata komunale

Paraqitet struktura e administratës komunale, e organizuar në 8 drejtori dhe njësi të ndryshme në kuadër të Kabinetit të Kryetarit. Kjo pjesë jep një pasqyrë të përgjithshme të organizimit dhe funksionimit të komunës.

2.3. Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Përshkruhen roli dhe përgjegjësitë e saj në rritjen e transparencës dhe informimit të qytetarëve. Theksohet publikimi i vazhdueshëm i lajmeve, dokumenteve dhe aktiviteteve në uebfaqe dhe rrjete sociale. Gjithashtu, evidentohet bashkëpunimi me drejtoritë komunale dhe mediat lokale. Kjo pjesë paraqet kanalet kryesore të komunikimit dhe mënyrën e informimit të publikut.

2.4. Korniza ligjore

Përshkruhen bazat juridike mbi të cilat mbështetet Strategjia, duke përfshirë Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse. Theksohet rëndësia e transparencës, informimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Gjithashtu, paraqiten obligimet e komunës për komunikim të hapur dhe qasje në dokumente publike. Kjo pjesë siguron bazën ligjore për zbatimin e strategjisë.

3. GJENDJA AKTUALE ME KOMUNIKIMET

Përshkruhet niveli aktual i transparencës dhe informimit në Komunën e Dragashit. Përveç komunikimit elektronik, organet komunale organizojnë takime publike, dëgjime buxhetore dhe konsultime publike për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

3.1. Perceptimet e qytetarëve

Paraqiten perceptimet dhe kënaqshmëria e qytetarëve sipas Anketës së HELVETAS&DEMOS 2024. 53% ndihen mirë të informuar, 30% marrin pjesë në takime publike, dhe 90% janë të kënaqur me cilësinë e punimeve. Gjithashtu, 69% deklarojnë se gjejnë informacionin/shërbimin e kërkuar, dhe 96% besojnë se Kuvendi Komunal arrin ta mbajë përgjegjës ekzekutivin.

3.2. Uebfaqja e Komunës dhe platformat sociale

Uebfaqja e Komunës së Dragashit shërben si platformë për publikimin e dokumenteve publike. Rrjeti social Facebook përdoret kryesisht për informimin mbi aktivitetet dhe takimet zyrtare, investimet kapitale dhe thirrjet publike për mbështetje financiare. Këto kanale lehtësojnë qasjen e qytetarëve në informacion dhe rrisin transparencën e institucioneve komunale.

3.3. Transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje

Komuna e Dragashit ka përmirësuar ndjeshëm transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Performanca e saj është vlerësuar lartë nga institute kredibile të transparencës dhe si rezultat ka përfituar për herë të katërt edhe Grantin e Performancës.

3.4. Marrëdhëniet me mediat

Komuna e Dragashit ka marrëdhënie aktive me mediat lokale, të cilat mbulojnë të gjithë territorin dhe përdorin edhe platformat online. Strategjia synon rritjen e mëtejshme të komunikimit përmes Zyrës për Informim, mediave elektronike, rrjeteve sociale dhe uebfaqes zyrtare.

3.5. Komunikimi i brendshëm

Komunikimi i brendshëm i administratës komunale ka përmirësuar performancën dhe motivimin e stafit, duke forcuar bashkëpunimin mes Kryetarit dhe drejtorëve. Strategjia synon qartësimin e detyrave dhe përgjegjësive për një komunikim më efikas dhe promovimin e një kulture organizative pozitive ndërmjet zyrtarëve dhe organeve komunale.

3.6. Bashkëpunimi me aktorë dhe faktorë të tjerë

Komuna e Dragashit ka zhvilluar bashkëpunim të ngushtë me OJQ-të, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat, duke mbështetur projekte të ndryshme. Gjithashtu, bashkëpunimi me organet shtetërore, përfaqësitë diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare ka ndihmuar në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve dhe mbështetjen e institucioneve lokale.

3.7. Promovimi dhe marketingu i Komunës

Komuna fokusohet në rritjen e transparencës dhe informimit për aktivitetet kulturore, sportive dhe ekonomike, si dhe për vlerat turistike dhe trashëgiminë. Përmes festivaleve, panairove dhe ngjarjeve sportive, si dhe platformës online Visit Dragash, komuna synon të tërheqë vizitorë dhe investitorë, duke ndërtuar imazhin e saj publik dhe duke zhvilluar potencialin ekonomik dhe turistik.

3.8. Vlerësimi vetanak – Analiza SWOT

Tregon se Komuna ka përparësi në uebfaqe funksionale, staf të motivuar dhe mekanizma komunikimi në rrjete sociale. Dobësitë lidhen kryesisht me dizajnin e uebfaqes dhe nevojën për përmirësim të teknologjisë. Mundësitë përfshijnë trajnime dhe zgjerim të kapaciteteve të ZI. Rreziqet lidhen me jofunksionalitetin e uebfaqes, ndryshimet ligjore dhe informimin e qytetarëve nga burime të pasakta.

4. PARIMET E KOMUNIKIMIT

Kapitulli 4 paraqet parimet që udhëheqin komunikimin e Komunës së Dragashit me publikun. Komuna angazhohet të respektojë të drejtën e qytetarëve për qasje të lirë dhe të barabartë në informacion, duke siguruar publikim në të gjitha gjuhët e komuniteteve dhe duke shmangur çdo diskriminim.

5. OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT

Kapitulli 5 përqendrohet tek objektivat strategjike të komunikimit të Komunës së Dragashit, me fokus në rritjen e efikasitetit të informimit dhe pjesëmarrjes qytetare. Konsultimi me grupet e interesuara konsiderohet një mjet kyç për përmirësimin e vendimeve dhe transparencës së institucionit.

Komuna ka identifikuar dy objektiva kryesore:

1. Krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me mediat

Synohet të strukturohet prezantimi mediatik, duke përdorur forma dhe materiale të ndryshme komunikimi, përfshirë mediat digjitale dhe platforma sociale. Personeli i Zyrës për Komunikim dhe Informim do të trajnohet për përdorimin efektiv të këtyre mjeteve, ndërsa marrëdhëniet me mediat lokale do të konsolidohen për të garantuar informim të drejtë dhe të saktë të publikut.

2. Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje

Strategjia synon t'u mundësojë qytetarëve qasje të lehtësuar në informacion dhe të nxisë përfshirjen e tyre aktive në vendimmarrje. Përmes kësaj qasjeje, Komuna synon të ndërtojë një klimë besimi, të mirëmbajë mekanizmat e transparencës dhe të forcojë bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e tjera të interesit.

6. FORMAT E KOMUNIKIMIT

Kapitulli 6 përshkruan format e ndryshme të komunikimit që përdor Komuna e Dragashit për të arritur një ndërveprim efektiv me publikun. Komunikimi ka evoluar ndër vite, duke filluar nga njoftimet fizike në tabela dhe thirrjet përmes radios lokale, deri te përdorimi i internetit dhe, më së fundi, rrjeteve sociale.

7. AUDIENCA, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR

Kapitulli 7 paraqet audiencat kryesore të komunikimit të Komunës së Dragashit, mesazhet që duhet të përcillen dhe impaktin që synohet të arrihet tek secili grup.

8. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Kapitulli 8 përshkruan rolet dhe përgjegjësitë kryesore të aktorëve në administratën komunale, duke përfshirë Kryetarin e Komunës, Zyrтарin për Informim, drejtorët e drejtorive dhe stafin, si dhe thekson rëndësinë e vetëdijesimit dhe koordinimit për implementimin e strategjisë së komunikimit.

9. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Kapitulli 9 paraqet mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026–2030, duke siguruar zbatimin efektiv të aktiviteteve dhe arritjen e objektivave. Ai paraqet mënyrat e raportimit vjetor, analizat e rezultateve dhe procesin e vlerësimit për të matur transparencën, pjesëmarrjen qytetare dhe efektivitetin e komunikimit institucional.

SHTOJCA: PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026–2030 përmbledh aktivitetet kryesore për dy objektivat strategjike. Plani përcakton përgjegjësitë, kohën e

realizimit, indikatorët e suksesit dhe kostot për secilin aktivitet, duke siguruar një bazë të qartë për zbatimin dhe monitorimin e efektivitetit të strategjisë.

Kjo ishte në përgjithësi një pasqyrë e shkurtër e strukturës së Draftit të Strategjisë. Tani është radha juaj. Ju lutem, nëse dikush prej jush ka ndonjë koment, sugjerim apo propozim konkret, mund ta merrni fjalën! Nëse nuk kemi, atëherë ju njoftoj se pas kalimit të këtyre procedurave të konsultimit publik, draftdokumenti do të procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës. Ju faleminderit edhe një herë për pjesëmarrjen tuaj!

Linqet e lajmeve për mbajtjen e diskutimit publik, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/news/u-mbajt-takimi-publik-lidhur-me-draftin-e-strategjise-per-komunikim-dhe-mirredhenie-me-publikun-2026-2030/>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/sr/news/danas-je-odrzan-javni-sastanak-u-uzi-sa-naortom-strategije-za-komunikaciju-i-odnose-s-javnoscu-2026-2030/>

Në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/18WjqwCPd/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1NTzB2MiML/>

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në diskutim publik dhe fotografitë*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 10.04.2026

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragash

**LISTA E PJESËMARRËSVE NË DISKUTIMIN PUBLIK PËR
DRAFTIN E STRATEGJISË PËR KOMUNIKIM DHE MARRËDHËNIE
ME PUBLIKUN 2026-2030**

**LISTA UÇESNIKA NA JAVNOJ RASPRAVI DRAFT
STRATEGIJA ZA KOMUNIKACIJU I ODNOSI SA JAVNOŠĆU 2026–2030**

Nr. Br.	Emri dhe Mbiemri Ime i Prezime	Vendbanimi Prebivalište	Etnia Etnička pripadnost	M M	F Ž	Nënshkrimi Potpis
1	FITIM SPATHIU	DRAGASH	SHQIPTAR	X		
2	Bashkim Dauti	DRAGASH	SHQIPTAR	X		
3	BENAR Selmani	KUK	SHQIPTAR	X		
4	HASIM SAITI	DRAGASH	SHQIPTAR	X		
5	VETON QAFLESHI	BELLOBRAD	SHQIPTAR	X		
6	ARDIT KALANDERI	KOCAVE	SHQIPTAR	X		
7	Usamedin Haruni	BROD	BOSHIJAK	X		
8	REDUP IBRAHIMI	PADESA	GORANI	X		
9	SUAD TOŠIHI	RAPÇE	BOSNIJAK	X		
10	FARU KOLLOVI	KOCAVE	SHQIPTAR	X		
11	Zahide Ahmeti	SHAJNE	SHQIPTAR		X	
12	Veton Halili	ZAPLUXHE	SHQIPTAR	X		
13	HEUTOR SELIMI	DRAGASH	SHQIPTAR	✓		
14	Adem Emin	ZGËTAR	SHQIPTAR	✓		
15	Elmedina Haxhi	DRAGASH	SHQIPTARE		✓	
16	Korim Jafri	DRAGASH	SHQIPTAR	✓		
17	RESHAT ALIJA	DRAGASH	SHQIPTAR	✓		
18	Mergona Berisha Jekifi	DRAGASH	SHQIPTAR		✓	
19	Dreni Myrtezani	ZAPLUXHE	SHQIPTAR	✓		
20	Merybe Ramadani	ZAPLUXHE	SHQIPTAR		✓	
21	Lirim Durrmani	BLAS	SHQIPTAR	✓		
22						
23		REPUBLIKA E KOSOVËS				
24		REPUBLIKA KOSOVA				

Komuna e Dragashit
Opština Dragaš
02 Nr. Br. 020/01-5684/26
10.04.2026
Dragash - Dragaš

